



Shkodër – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Kontigjenti”

Lëvizte si pasagjer në një automjet, i armatosur me pistoletë, kapet në flagrancë dhe vihet në pranga 22-vjeçari.

Sekuestrohen një armë zjarri pistoletë dhe një sasi lënde narkotike kanabis.

Në lagjen "Liria", shërbimet e Policisë kanë ndaluar për kontroll, automjetin që drejtohej nga shtetasi T. P. dhe ku ishte pasagjer shtetasi B. C. Shtetasi T. P. ka braktisur automjetin dhe duke përfitur nga kushtet e errësirës, ka mundur t'u shmanget shërbimeve të Policisë. Vijon puna intensive, me qëllim kapjen e tij.

Në cilësinë e provës materiale, u sekuestruan një armë zjarri pistoletë dhe një sasi lënde e dyshuar narkotike kanabis.

<https://youtu.be/RojrHVtQwoE>

